



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	26/11/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Ismet HYSENI Udhëheqës i Prokurimit – Ministria e Shëndetësisë
CC:	z. Gani SHABANI Sekretar i Përgjithshëm – Ministria e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	<i>për</i> Hasan PRETENI <i>Am</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Furnizim me material shpenzues medicinal nga Lista Esenciale”

I nderuari z. HYSENI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Furnizim me material shpenzues medicinal nga Lista Esenciale” Lotet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 43, 44, 45, 49, 50, 55, 56, 57.” me nr. prokurimi : 206-14-022-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik “Furnizim me material shpenzues medicinal nga Lista Esenciale” Lotet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 43, 44, 45, 49, 50, 55, 56, 57.” me nr. prokurimi:206-14-022-111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, bazuar në nevojën e sajë për Furnizime me Pajisje medicinale, ka paraparë aktivitet prokurimi me *Procedurë të Hapur*. Autoriteti Kontraktues ka përgatitë *Njoftimin për Kontratë* me titull: “Furnizim me material shpenzues medicinal nga Lista Esenciale” (Lotet; 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 43, 44, 45, 49, 50, 55, 56, 57) me nr. prokurimi: 206-14-022-111, e cila është publikuar më datë 23/05/2014 në faqen elektronike të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP. Kjo procedurë në vetvete përmban tenderin të ndarë në gjashtëdhjetë(60) LOTE.

Në “Njoftim për Kontratë” në pikën III.2 Kushtet për pjesëmarrje, nën pika III.2.4 Kapaciteti Teknik dhe profesional kërkohet: *“Dëshmi që materiali është i prodhuar apo regjistruar në së paku një vend të BE-së ; Schengen-it, Britani e madhe, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Izrael, Australi, Zelandë e Re, Turqi (të prodhuara në Turqi)”* Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka paracaktuar vendin e origjinës për produktet që do të furnizohet. Me përkufizimin e vendit të origjinës për pajisjet furnizuese, Autoriteti Kontraktues favorizon Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminohen disa të tjerë. Nëse Autoriteti Kontraktues iu është referuar Udhëzuesit Administrativ për produkte medicinale i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, Agjencia nuk ka gjetur elemente që ky udhëzim e mbulon edhe furnizimin me pajisje medicinale.

Operatori Ekonomik Ankues ishte shpallur i Pa Përgjegjshëm nga Autoriteti Kontraktues, pasi nuk kishte ofruar autorizim të vulosur nga prodhuesi. I pa kënaqur me vlerësimin e ofertave nga Autoriteti Kontraktues Operatori Ekonomik “FRIENDS” ka bërë ankesë në OSHP. Me vendimin e OSHP-së 283/14 të datës 08/09/2014 aprovohet pjesërisht ankesën e Operatorit Ekonomik “FRIENDS” dhe kthehet në ri vlerësim tenderi. Me këtë vendim, po ashtu OSHP i jep të drejtë Operatorit Ekonomik ankues, pasi Autoriteti Kontraktues nuk e kishte kërkuar Autorizimin e vulosur në Dosjen e Tenderit.

Gjatë kohës kur lënda ishte në proces ankimimi në OSHP, kalonte afati i vlefshmërisë së tenderit. Më 05/09/2014 ka qenë data kur vlefshmëria e tenderit ka kaluar. Autoriteti Kontraktues, më datë 02/09/2014 ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik Ofertues që nëse janë të interesuar të zgjasin vlefshmërinë e tenderit. Të gjithë Operatorët Ekonomik iu janë përgjigjur Autoritetit Kontraktues në afatin e paraparë ligjor, përpos Operatorit Ekonomik ankues, i cili nuk e kishte vazhduar vlefshmërinë e tenderit deri më datë 08/09/2014. Përgjigja e Operatorit Ekonomik ankues ishte se vazhdimin e vlefshmërisë së tenderit e bëjmë pasi kemi marrë përgjigjen nga OSHP. Për këtë çështje Autoriteti Kontraktues më datë 26/09/2014 ka kërkuar interpretim profesional nga KRPP. Përgjigja e KRPP e datës 29/09/2014 është: “Andaj në rastin tuaj kuptohet se keni kërkuar nga OE zgjatjen e vlefshmërinë para skadimit të afatit, të tjerët e kanë konfirmuar në rregull, por njëri nga OE në fjalë ka shkëput vlefshmërinë sepse nuk e ka nga data e skadimit por tri ditë më vonë, kështu që KRPP mendon se ajo ofertë nuk mund të konsiderohet si e përgjegjshme”

Autoriteti Kontraktues, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor në OSHP të datës 3/shtator/2014 kishe njoftuar të pranishmit se dyshonin se Autorizimi i ofruar nga Operatori Ekonomik "FRIENDS" nuk është siç duhet. Dyshonin se Operatori Ekonomik "FRIENDS" kishte falsifikuar dokumentacionin dhe të njëjtit nuk kishin gjetur fakte se një kompani e tillë ekziston në adresën që ishte paraqitur në dokumentacion në lidhje me prodhuesin "JOHNSON&FRIEND". OSHP edhe pse ka qenë e informuar nga Autoriteti Kontraktues me pretendimet se dokumentet mund të ishin falsifikuar, nuk ka arritur të vërtetoj këtë fakt.

Me pranimin e këtij informacioni, Agjencia Kundër Korrupsion ka hetuar dhe ka gjetur fakte se Operatori Ekonomik "FRIENDS" ka lajthitur Autoritetin Kontraktues dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit duke paraqitur Certifikatë false në Ofertën e tij, për tenderin: "Furnizim me material shpenzues medicinal nga Lista Esenciale". Në Certifikatën e ofruar me nr: G2 10 07 73111 004 adresa e prodhuesit është: JOHNSON&FRIENDS Group Corporation Ltd, 32 Orsman Road London, N1 5QJ, United Kingdom.

Agjencia Kundër Korrupsion ka kërkuar nga Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale – AKPM të na vejë në dispozicion llojin e certifikatës, me të cilën Operatori Ekonomik "FRIENDS" është regjistruar si importues në këtë institucion. Sipas dokumentacionit të ofruar nga AKPM, **kemi gjetur se Operatori Ekonomik në Dosjen e Tenderit të dorëzuar tek Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur dokumente autentike.**

Në certifikatën me nr: G2 10 07 73111 004 e siguruar nga AKPM, adresa e prodhuesit është: JOHNSON&FRIENDS Group Corporation, Tangpu Economic Development Zone, 313300 Anji City, Zhejiang Province, PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA. Operatori Ekonomik gjithashtu ka falsifikuar edhe kategoritë e produkteve (*Products Category(ies)*) në Certifikata, duke ia përshtatur kërkesave nga Dosja e Tenderit të Autoritetit Kontraktues. Pothuajse veprimi është i njëjtë në disa certifikata të prezantuara për prodhuesin në fjalë.

Operatori Ekonomik gjatë komunikimit elektronik dhe me dokumentacione, ka paraqitur edhe web adresën e prodhuesit www.johnsonsfriends.com, e cila adresë sipas hetimeve të Agjencisë në "Domain Dossier, Investigate domains and IP addresses", del se web faqja menaxhohet nga një web faqe nga Kosova www.trokit.com. Agjencia kundër Korrupsion dyshon se Operatori Ekonomik "FRIENDS" vet iu është përgjigjur pyetjeve nga Autoriteti Kontraktues, përgjigjet i ka dhënë në cilësinë e prodhuesit "JOHNSON&FRIENDS"

Autoriteti Kontraktues i shtyrë nga vendimi i OSHP-së dhe nga urdhëresat e njëpasnjëshme nga ky organ, ka kthyer në ri vlerësim tenderin në fjalë dhe sipas "Njoftim për Dhënie të Kontratës" të datës 22/10/2014, pika IV.4) **Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, të cilit i është dhënë kontrata për llotet: 1, 2, 3, 4, 7, 8, 10, 13, 14, 15, 18, 19, 20, 28, 29, 30, 51, është: Emri zyrtar: "Friends Medical"**

Ministria e Shëndetësisë si dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit ka obligim ligjor dhe duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mos lejuar që Operatorë Ekonomik të këtij niveli të ofertojnë në tender të tillë. Akoma më shumë vëshitrësohet ky veprim, kur kemi të bëjmë me pajisje medicinale, të cilat prekin drejtëpërdrejtë në shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë aktivitetit të prokurimit

Veprimet e Autoriteteve të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim; nenin 27 Dosja e Tenderit; si dhe **Nenin 99 Funkcionet dhe Kompetencat e OSHP-së** të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Autoritetet e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

